



Pranim / Dorëzuar Pamirjes / Prerodalo Received / Delivered	13.03	3	viti god Year
Organ / Njësia Org / Unit	Nr Prot In Prot Prot No	Shlop / Prilog Appendix	Sasia Kolicime Quantity
SKMSTICK	2594/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.343/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.343/2023 të datës 09.02.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit/Komuna e Lipjanit, në çështjen juridike "*kompensim material*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 13.03.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.343/2022 e datës 09.02.2023, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Nëpunësi civil i punësuar në Komunën e Lipjanit, më datë 09.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1655/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me shkrim të datës 08.02.2023 të organit të punësimit/Zyrës së Personelit të Komunës së Lipjanit lidhur me refuzimin e kërkesës së ankuesit për kompensimin e mjeteve financiare në mënyrë retroaktive në emër të diferencës së koeficienti të pagës nga shtatë pike pesë (7.5) në tetë pika pesë (8.5), për periudhën nga data 20.11.2014 deri me tani.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 15.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Lipjanit. Ndërsa, Këshilli me datë 28.02.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1655/2023 të datës 09.02.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës;; Përgjigjen në kërkesë me numër 1-120/04-5254 të datës 08.02.2023 të Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Lipjanit; Aktin emërimit të datës 01.05.2013 të ankuesit; Shkresën me numër të protokollit 6038 të datës 27.11.2014 të DASHC/MAP-04/1571; Kërkesën me numër 1-120/04-5254 të datës 30.01.2023; Emalin e datës 02.09.2023 të M.Miftari drejtuar KPMSHCK-së; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 1827/2023 të datës 15.02.2023; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 2159/2023 të datës 28.02.2023; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 09.10.2012; Përgjigjen në kërkesë të datës 08.02.2023; Kërkesën me numër 1-120/04-5254 të datës 30.01.2023 për kompensimin e dëmit drejtuar Zyrës së Personelit; Listën e pagave për muajin Nentor-2022; Listën e pagave për muajin Dhjetor-2022.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezultoi se ankuesi është i punësuar në Komunën e Lipjanit në pozitën e punës Shef i Sektorit të Pylltarisë. I njëjti më datë 13.12.2022 kishte parashtruar ankesë për harmonizimin e koeficientit të pagës nga shtatë pikë pesë (7.5) në tetë pikë pesë (8.5), në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ky i fundit me Vendimin A.nr.1171/2022 të datës 20.01.2023 ka përfunduar procedurën administrative lidhur me ankesën e ankuesit, me arsyetimin se duke marr parasysh se pretendimet ankimore të ankuesit kanë pas për objekt çështjen e realizimit të koeficientit të pagës, Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i cili parasheh rregulla dhe kushte tjera për përcaktimin e pagës të të punësuarve në sektorin publik, duke përfshi edhe koeficientet dhe nivelet e koeficienteve të pagës të cilat ndryshojnë nga rregullat dhe sistemi aktual i pagave.

Ankuesi më datë 30.01.2023 ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Personelit në Komunën e Lipjanit për kompensimin retroaktiv të diferencës së koeficientit nga data 20.11.2014 deri me tani. Udhëheqësi i Personelit përmes përgjigjes së datës 08.02.2023 ka refuzuar kërkesën e ankuesit të datës 30.01.2023 me arsyetimin se Zyra e Personelit, nuk është kompetent për ndryshimin e koeficientit, pasi që ndryshimi i koeficientit munde të bëhet vetëm me zhvillimin e procedurave të rekrutimit siç është parapare me ligj.

I pakënaqur me përgjigjen e datës 08.02.2023 të organit të punësimit, ankuesi me datë 09.02.2023 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e diferencës së koeficientit të pagës nga shtatë pike pesë (7.5) në tetë pika pesë (8.5), për periudhën nga data 20.11.2014 deri me tani.

Kolegji i Këshillit shqyrtoj pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me kompensimin e diferencës së një koeficienti të pagës në mënyrë retroaktive dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit si i tillë nuk është i bazuar, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedh se ankuesi me datë 01.05.2013 kishte nënshkruar pa vërejtje aktin e emërimit për pozitën e punës *Shef i Sektorit të Pylltarisë*, me koeficient të pagës shtatë pikë pesë (7.5), dhe se i njëjti edhe përkundër faktit se ka qenë në djeni lidhur me koeficientin e përcaktuar të pagës nuk ka ndërmarr asnjë



veprim juridik në kuptim të harmonizimit të koeficientit të pagës me vendin e punës deri me datë 13.12.2022, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative (ligj ky i aplikueshëm në kohën kur ankuesi kishte nënshkruar aktin e emërimit me datë 01.05.2013), përkatësisht nenin 130 të këtij ligji ku përcaktohet se: 130.1. Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*


KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.343/2023

Ilire Mehmeti-SHAQIRI


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

